FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Valomindo 160 mg/1,5 mg tableta me lirim të modifikuar

valsartan/indapamid

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.
- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'u bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njejta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit tuaj. Shih seksionin 4.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Valomindo dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Valomindo
3. Si të merrni Valomindo
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Valomindo
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË VALOMINDO DHE PËR SE PËRDORET

Valomindo i përmban dy substanca aktive që quhen valsartan dhe indapamid.

Valsartani i përket një klase të barnave që njihen si bllokues të receptorit të angiotenzinës II, të cilët ndihmojnë në kontrollin e shtypjes së lartë të gjakut. Angiotensina II është një substancë në trup që bën që enët e gjakut të shtrëngohen, duke bërë kështu që shtypja e gjakut tuaj të ngritet. Ajo funksionon duke e bllokuar efektin e angiotenzinës II. Si rezultat, enët e gjakut relaksohen dhe shtypja e gjakut ulet.

Indapamidi është diuretik. Shumica e diuretikëve e rrisin sasinë e urinës së prodhuar nga veshkat. Megjithatë, indapamidi është i ndryshëm nga diuretikët e tjerë, meqë e shkakton vetëm një rritje të lehtë të sasisë së urinës së prodhuar.

Ky bar ka për qëllim ta reduktojë shtypjen e lartë të gjakut (hipertensionit) tek të rriturit. Mjeku juaj mund t'ju përshkruajë Valomindo nëse tashmë jeni duke marrë valsartan dhe indapamid në të njëjtin nivel të dozës, por si tableta të veçanta.

2. PARA SE TË MERRNI VALOMINDO

Mos merrni Valomindo
- nëse jeni alergjik ndaj valsartanit, indapamidit, ndonjë sulfonamidi tjetër ose ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari (të renditur në pjesën 6).
- nëse keni sëmundje të mëlçisë ose vuani nga një sëmundje që quhet encefalopatia hepatike (sëmundje degjenerative e trurit).
- nëse jeni shtatzënë për më shumë se 3 muaj (është gjithashtu më mirë që ta shmangni Valomindo në shtatzëninë e hershme - shihni pjesën për shtatzëninë).
- nëse keni diabet ose funksion të dëmtuar të veshkave dhe jeni duke u trajtuar me ndonjë bar për

uljen e shtypjes së gjakut që përmban aliskiren.
- nëse keni sëmundje të rëndë të veshkave.
- nëse keni nivele të ulëta të kaliumit në gjakun tuaj.

Tregoni kujdes të veçantë me Valomindo
Bisedoni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të merrni Valomindo:
- nëse keni sëmundje të mëlçisë.
- nëse keni sëmundje të rëndë të veshkave ose nëse jeni në dializë.
- nëse vuani nga ndonjë ngushtim i arteries së veshkave.
- nëse kohët e fundit i jeni nënshtruar transplantit të veshkave (keni marrë një veshkë të re).
- nëse keni sëmundje të rënda të zemrës përveç dështimit të zemrës ose sulmit në zemër.
- nëse keni përjetuar ndonjëherë ënjtje të gjuhës dhe fytyrës të shkaktuar nga një reaksion alergjik që quhet angioedemë pasi keni marrë ndonjë bar tjetër (përfshirë frenuesit e ACE-së), tregoni mjekut tuaj. Nëse këto simptoma shfaqen kur jeni duke marrë Valomindo, ndaloni menjëherë marrjen e Valomindo dhe mos e merrni më kurrë. Shih edhe pjesën 4 për "Efektet anësore të mundshme".
- nëse jeni duke marrë barna që e rrisin sasinë e kaliumit në gjakun tuaj. Këto përfshijnë suplementet e kaliumit ose zëvendësuesit e kripës që përmbajnë kalium, barnat që kursejnë kalium dhe heparinën. Mund të jetë e nevojshme ta kontrolloni sasinë e kaliumit në gjak në intervale të rregullta.
- nëse vuani nga aldosteronizmi. Kjo është një sëmundje në të cilën gjëndrat mbiveshkore prodhojnë shumë hormon të aldosteronit. Nëse kjo vlen për ju, përdorimi i Valomindo nuk rekomandohet.
- nëse keni humbur shumë lëngje (dehidratim) të shkaktuar nga diarreja, të vjellat ose dozat e larta të tabletave të ujit (diuretikët).
- nëse jeni duke marrë ndonjë nga barnat e mëposhtme që përdoren për ta trajtuar shtypjen e lartë të gjakut:
  - ndonjë frenues të ACE-së (për shembull enalapril, lisinopril, ramipril), veçanërisht nëse keni probleme të veshkave që lidhen me diabetin,
  - aliskiren.
- nëse keni diabet.
- nëse vuani nga cerma.
- nëse keni ndonjë problem me ritmin e zemrës.
- nëse duhet ta bëni një analizë për të kontrolluar se sa mirë funksionon gjëndra juaj paratiroide.

Ju duhet t'i tregoni mjekut tuaj nëse keni pasur reaksione të fotosensitivitetit.

Nëse keni rënie të të pamurit ose dhimbje në sy. Këto mund të jenë simptoma të akumulimit të lëngjeve në shtresën vaskulare të syrit (derdhja koroidale) ose të një rritjeje të shtypjes në syrin tuaj dhe mund të paraqiten brenda disa orëve deri në disa javë pas marrjes së indapamidit. Kjo mund të çojë në humbje të përhershme të të pamurit, nëse nuk trajtohet. Nëse më parë keni pasur alergji ndaj penicilinës ose sulfonamidit, mund të jeni në rrezik më të lartë për ta përjetuar këtë.

Mjeku juaj mund ta kontrollojë funksionin e veshkave, shtypjen e gjakut dhe sasinë e elektroliteve (p.sh. kaliumit) në gjakun tuaj në intervale të rregullta.

Shih edhe informatat nën titullin "Mos merrni Valomindo".

Ju duhet t'i tregoni mjekut tuaj nëse mendoni se jeni (ose mund të mbeteni) shtatzënë. Valomindo nuk rekomandohet në shtatzëninë e hershme dhe nuk duhet të merret nëse jeni shtatzënë për më shumë se 3

muaj, meqë kjo mund t'i shkaktojë dëm serioz fëmijës tuaj nëse përdoret në atë fazë (shih pjesën për shtatzëninë).

Nëse ndonjëra nga këto vlen për ju, tregoni mjekut tuaj para se të merrni Valomindo.

Informata të rëndësishme për atletët
Atletët duhet të jenë të vetëdijshëm se ky bar përmban përbërës aktiv, të cilit mund të japin reaksion pozitiv në testet e dopingut.

Fëmijët dhe adoleshentët
Për shkak të mungesës së të dhënave për sigurinë dhe efikasitetin, përdorimi i këtij bari nuk rekomandohet për fëmijët dhe adoleshentët.

Marrja e barnave të tjera
Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Efekti i trajtimit mund të ndikohet nëse Valomindo merret së bashku me disa barna të tjera. Mund të jetë e domosdoshme që ta ndryshoni dozën, të merrni masa të tjera paraprake ose, në disa raste, ta ndërpritni marrjen e njërit prej barnave. Kjo vlen si për barnat me recetë, ashtu edhe për ato pa recetë.

Sigurohuni që t'i tregoni mjekut tuaj nëse jeni duke e marrë ndonjërin nga barnat në vijim, pasi mund të kërkohet kujdes i veçantë:
- barnat e tjera që e ulin shtypjen e gjakut, veçanërisht tabletat e ujit (diuretikët), frenuesit e ACE-së (siç janë enalaprili, lisinoprili, etj.) ose aliskireni (shih edhe informatat nën titujt "Mos merrni Valomindo" dhe "Tregoni kujdes të veçantë me Valomindo"),
- barnat që e rrisin sasinë e kaliumit në gjakun tuaj. Këto përfshijnë suplementet e kaliumit ose zëvendësuesit e kripës që përmbajnë kalium, barnat që kursejnë kalium dhe heparinën.
- ndonjë lloj të caktuar i qetësuesve të dhimbjes të quajtur barna anti-inflamatore jo-steroide (NSAID),
- disa antibiotikë (grupi i rifamicinës), ndonjë bar që përdoret për t'u mbrojtur nga refuzimi i transplantit (ciklosporina) ose ndonjë bar antiretroviral që përdoret për trajtimin e infeksionit HIV/AIDS (ritonavir). Këto barna mund ta rrisin efektin e Valomindo.
- litiumi (një bar që përdoret për t'i trajtuar disa lloje të sëmundjeve psikiatrike),
- barnat që përdoren për problemet e ritmit të zemrës (p.sh. kinidina, hidrokinidina, dizopiramidi, amiodaroni, sotaloli, ibutilidi, dofetilidi, digitalisi),
- barnat që përdoren për trajtimin e çrregullimeve mendore siç janë depresioni, ankthi, skizofrenia … (p.sh. antidepresivët triciklikë, barnat antipsikotike, neuroleptikët),
- bepridili (përdoret për trajtimin e anginës pektoris, një gjendje që shkakton dhimbje të gjoksit),
- cisapridi, difemanili (përdoren për trajtimin e problemeve gastro-intestinale),
- sparfloksacina, moksifloksacina, eritromicina me injeksion (antibiotikë që përdoren për trajtimin e infeksioneve),
- vincamina me injeksion (përdoret për trajtimin e çrregullimeve konjitive simptomatike tek të moshuarit, duke përfshirë humbjen e kujtesës),
- halofantrina (bar antiparazitar që përdoret për trajtimin e disa llojeve të malaries),
- pentamidina (përdoret për trajtimin e disa llojeve të pneumonisë),
- mizolastina (përdoret për trajtimin e reaksioneve alergjike, siç janë ethet e barit),
- barnat anti-inflamatore jo-steroide për lehtësimin e dhimbjeve (p.sh. ibuprofeni) ose dozat e larta të acidit acetilsalicilik,

- frenuesit e enzimës konvertuese të angiotenzinës (ACE-së) (përdoren për trajtimin e shtypjes së lartë të gjakut dhe dështimit të zemrës),
- amfotericina B me injeksion (barnat antifungale),
- kortikosteroidet orale që përdoren për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, duke përfshirë astmën e rëndë dhe artritin reumatoid,
- laksativët stimulues,
- baklofeni (për ta trajtuar shtangien e muskujve që ndodh tek sëmundjet siç është skleroza e shumëfishtë),
- diuretikët që kursejnë kalium (amiloridi, spironolaktoni, triamtereni),
- allopurinoli (për trajtimin e cermës),
- metformina (për trajtimin e diabetit),
- media kontrasti me jod (përdoret për teste që përfshijnë rentgenin),
- tabletat e kalciumit ose suplementet e tjera të kalciumit,
- ciklosporina, takrolimusi ose barnat e tjera për ta ulur sistemin imunitar pas transplantimit të organeve, për t'i trajtuar sëmundjet autoimune ose sëmundjet e rënda reumatike ose dermatologjike,
- tetrakosaktidi (për ta trajtuar sëmundjen e Crohn-it).

Marrja e Valomindo me ushqim dhe pije
Ju mund të merrni Valomindo me ose pa ushqim.

Shtatzënia dhe gjidhënia
Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.
Nëse jeni shtatzënë ose duke ushqyer me gji, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose planifikoni të bëni fëmijë, kërkoni këshilla nga mjeku apo farmacisti i juaj para se ta merrni këtë bar.

- **Ju duhet t'i tregoni mjekut tuaj nëse mendoni se jeni (ose mund të bëheni) shtatzënë.** Mjeku juaj normalisht do t'ju këshillojë të ndaloni marrjen e Valomindo para se të mbeteni shtatzënë ose sapo ta dini se jeni shtatzënë dhe do t'ju këshillojë që ta merrni ndonjë bar tjetër në vend të Valomindo. Valomindo nuk rekomandohet në shtatzëninë e hershme dhe nuk duhet të merret nëse jeni shtatzënë për më shumë se 3 muaj, meqë kjo mund t'i shkaktojë dëm serioz fëmijës tuaj nëse përdoret pas muajit të tretë të shtatzënisë.

- **Tregojini mjekut tuaj nëse jeni duke ushqyer me gji ose po mendoni ta filloni ushqyerjen me gji.** Valomindo nuk rekomandohet për nënat që ushqejnë me gji, ndërsa mjeku juaj mund të zgjedhë një trajtim tjetër për ju nëse dëshironi që të ushqeni me gji, veçanërisht nëse fëmija juaj është i porsalindur ose ka lindur para kohe.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive
Para se ta vozitni ndonjë automjet, të përdorni mjete apo të përdorni makina, ose të kryeni aktivitete të tjera që kërkojnë përqendrim, sigurohuni që ta dini se si Valomindo ndikon në ju. Ashtu si shumë barna të tjera që përdoren për ta trajtuar shtypjen e lartë të gjakut, Valomindo mund të shkaktojë marramendje ose lodhje dhe të ndikojë në aftësinë për t'u përqendruar. Nëse kjo ndodh, ju duhet të përmbaheni nga vozitja dhe aktivitetet e tjera që kërkojnë vigjilencë.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërsit e Valomindo

3. SI TË MERRET VALOMINDO

Gjithmonë merrni Valomindo saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Doza e rekomanduar e Valomindo është një tabletë në ditë, preferohet në mëngjes. Merrni Valomindo përafërsisht në të njëjtën kohë çdo ditë.

Tabletat mund të merren pavarësisht nga vaktet e ushqimit. Ato duhet të gëlltiten të tëra me ujë. Mos i shtypni apo përtypni ato.

Njerëzit me shtypje të lartë të gjakut shpesh nuk e vërejnë asnjë shenjë të këtij problemi. Shumë mund të ndihen mjaft normal. Kjo e bën edhe më të rëndësishme për ju që t'i vazhdoni terminet me mjekun edhe nëse ndiheni mirë. Trajtimi për shtypje të lartë të gjakut është zakonisht i përjetshëm.

Nëse merrni Valomindo më shumë se ç'duhet
Nëse keni marrë shumë tableta, kontaktoni menjëherë mjekun ose farmacistin tuaj.

Nëse keni marramendje të rëndë dhe/ose të fikët, shtrihuni.

Një dozë shumë e madhe e Valomindo mund të shkaktojë të përziera, të vjella, shtypje të ulët të gjakut, ngërçe, marramendje, përgjumje, konfuzion dhe ndryshime në sasinë e urinës së prodhuar nga veshkat.

Nëse harroni të merrni Valomindo
Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.
Nëse harroni të merrni një dozë të barit tuaj Valomindo, merreni dozën tjetër në kohën e zakonshme.

Nëse e ndërprisni marrjen e Valomindo
Duke qenë se trajtimi për shtypje të lartë të gjakut është zakonisht i përjetshëm, **ju duhet të diskutoni me mjekun tuaj para se ta ndërpritni marrjen e këtij produkti mjekësor.** Mos e ndërpritni marrjen e këtij bari nëse nuk ju thotë mjeku.

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit tuaj.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Valomindo mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo te të gjithë paraqiten ato.

Mos e merrni këtë produkt mjekësor dhe shkoni te mjeku juaj muaj menjëherë nëse e përjetoni cilindo nga efektet anësore në vijim:
- angioedema dhe/ose urtrikaria. Angioedema karakterizohet nga ënjtja e lëkurës së gjymtyrëve ose fytyrës, ënjtja e buzëve ose gjuhës, ënjtja e mukozës së fytit ose e rrugëve të frymëmarrjes që rezulton me gulçim ose vështirësi në gëlltitje. Nëse kjo ndodh, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj. (Shumë e rrallë) (*mund të prekë deri në 1 në 10 000 njerëz*)
- reaksionet e rënda të lëkurës, duke përfshirë skuqjen intensive të lëkurës, skuqja e lëkurës në tërë trupin tuaj, kruajtja të rëndë, flluskat, lëkura dhe ënjtja e lëkurës, pezmatimi i membranave të mukozë (sindroma Stevens-Johnson, nekroliza epidermike toksike) ose reaksionet alergjike të tjera. (Shumë e rrallë) (*mund të prekë deri në 1 në 10 000 njerëz*)

- rrahjet e parregullta kërcënuese për jetën. (Shumë e rrallë) (*mund të prekë deri në 1 në 10 000 njerëz*)
- pankreasi i inflamuar që mund të shkaktojë dhimbje të forta të barkut dhe shpinës të shoqëruara me ndjenjë të të qenit i sëmurë. (Shumë e rrallë) (*mund të prekë deri në 1 në 10 000 njerëz*)
- sëmundja e trurit e shkaktuar nga sëmundja e mëlçisë (Encefalopatia hepatike). (Nuk dihet)
- inflamacioni i mëlçisë (Hepatiti). (Nuk dihet)

Nëse e keni cilëndo nga këto simptoma, ndërpriteni marrjen e Valomindo dhe kontaktoni menjëherë mjekun tuaj (shih edhe pjesën 2 për "Tregoni kujdes të veçantë me Valomindo").

Efekte e tjera anësore përfshijnë:

Të zakonshme (mund të prekin deri në 1 në 10 persona):
- niveli i ulët i kaliumit në gjak
- reaksionet alergjike, kryesisht dermatologjike, tek subjektet me predispozicion ndaj reaksioneve alergjike dhe astmatike
- skuqja e lëkurës me ngritje dhe ngjyrë të kuqe

Të pazakonshme (mund të prekin deri në 1 në 100 njerëz):
- natriumi i ulët në gjak që mund të çojë në dehidrim dhe shtypje të ulët të gjakut
- ndjesia e rrotullimit (vertigo)
- kolla
- të vjellat
- dhimbjet e barkut
- pikat e kuqe në lëkurë (purpura)
- impotenca (paaftësia për të arritur ose mbajtur ereksion)
- lodhja

Të rralla (mund të prekin deri në 1 në 1000 njerëz):
- kloruri i ulët në gjak
- magnezi i ulët në gjak
- dhimbjet e kokës
- ndjesi shpimi gjilpërash, si gjilpëra (parestezia)
- çrregullimet gastro-intestinale (siç janë të përzierat, kapsllëku)
- goje e thatë

Shumë të rralla (mund të prekin deri në 1 në 10 000 njerëz):
- ndryshimet në qelizat e gjakut, siç janë trombocitopenia (ulja e numrit të trombociteve që shkakton mavijosje të lehtë dhe gjakderdhje nga hunda), leukopenia (ulja e rruazave të bardha të gjakut që mund të shkaktojë ethe të pashpjegueshme, dhimbje të fytit ose simptoma të tjera të ngjashme me gripin - nëse kjo ndodh, kontaktoni mjekun tuaj) dhe anemia (ulja e rruazave të kuqe të gjakut)
- niveli i lartë i kalciumit në gjak
- shtypja e ulët të gjakut
- funksioni jonormal i mëlçisë
- sëmundjet e veshkave (që shkaktojnë simptoma të lodhjes, nevojë të shtuar për urinim, kruajtje në lëkurë, ndjesi të të qenit i sëmurë, ënjtje të gjymtyrëve)

Nuk dihen (shpeshtësia e tyre nuk mund të vlerësohet nga të dhënat në dispozicion):

- ulja e nivelit të hemoglobinës dhe ulja e përqindjes së rruazave të kuqe në gjak (që në raste të rënda mund të çojë në anemi)
- rritja e nivelit të kaliumit në gjak (që mund të nxitë spazma të muskujve, ritëm jonormal të zemrës në raste të rënda)
- humbja e papritur e vetëdijes (sinkopa)
- shkurtpamësia (miopia)
- shikimi i turbullt
- të pamurit e dëmtuar
- ulja e të pamurit ose dhimbjet në sytë tuaj për shkak të shtypjes së lartë (shenja të mundshme të akumulimit të lëngjeve në shtresën vaskulare të syrit (efuzioni koroidal) ose glaukoma akute me mbyllje të këndit)
- gjurmimi jonormal i zemrës në EKG
- njollat e kuqe të purpurta, ethet, kruajtja (shenja të inflamacionit të enëve të gjakut që quhen edhe vaskulit)
- ngritja e vlerave të funksionit të mëlçisë (që mund të tregojnë dëmtim të mëlçisë), duke përfshirë një rritje të bilirubinës në gjak (e cila mund të shkaktojë zverdhje të lëkurës dhe syve në raste të rënda)
- nëse vuani nga lupusi eritematoz sistemik (një çrregullim i sistemit imunitar që çon në inflamacion dhe dëmtim të nyjave, tendinave dhe organeve me simptoma që përfshijnë skuqjet e lëkurës, lodhjen, humbje të oreksit, shtimin në peshë dhe dhimbjet në nyja), kjo mund të përkeqësohet
- janë raportuar edhe raste të reaksioneve të fotosenzitivitetit (ndryshime në pamjen e lëkurës) pas ekspozimit në diell ose rrezeve ultraviolete artificiale
- skuqja e lëkurës
- kruajtja e lëkurës
- dhimbjet e muskujve
- rritja e nivelit të kreatininës në serum (që mund të tregojë funksion jonormal të veshkave)
- rritja e nivelit të glukozës në gjak tek pacientët me diabet
- rritja e acidit urik, një substancë që mund ta shkaktojë ose përkeqësojë cermën (dhimbjet në nyje (a), posaçërisht në këmbë)

Raportimi i efekteve anësore
Nëse keni ndonjë efekt anësor, bisedoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin çdo efekt anësor të mundshëm që nuk është përmendur në këtë fletudhëzim. Ju gjithashtu mund t'i raportoni efektet anësore drejtpërsëdrejti, nëpërmjet sistemit kombëtar të raportimit.
Duke i raportuar efektet anësore, ju mund të ndihmoni të dhënien e më shumë informatave për sigurinë e këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET VALOMINDO

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Valomindo pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Ruajeni në paketimin origjinal të mbrojtur nga drita dhe lagështia.
Ky bar nuk kërkon kushte të posaçme të temperaturës për ruajtje.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

6. INFORMATA SHTESË

Çka përmban Valomindo

- Substancat aktive janë valsartan dhe indapamid.
  1 tabletë me lirim të modifikuar përmban 160 mg valsartan dhe 1,5 mg indapamid.
- Përbërësit e tjerë:
  Shtresa e valsartanit: celulozë mikrokristaline, krospovidon, silicë anhidër koloidale dhe stearat magnezi.
  Shtresa e indapamidit: celulozë mikrokristaline, manitol, hipromelozë, silicë anhidër koloidale, stearat magnezi, karbomere dhe oksid hekuri i verdhë (E172).

Si duket Valomindo dhe përbërja e paketimit
Tableta të rrumbullakëta, bikonvekse me dy shtresa. Njëra shtresë është e verdhë në kafe të lehtë, me lara, me shenjën VI2. Shtresa tjetër është e bardhë në të verdhë të bardhë. Dimensionet e tabletës: diametri rreth 11 mm.

Valomindo gjendet në kuti që përmbajnë 30 tableta me lirim të modifikuar në blistera.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi
KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në
02/2025.